



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

Nr. ____ prot.

Himarë, më ____ . ____ .2024

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot më datë ____/____/2024 në Bashkinë Himarë, nga Njësia e Prokurimit, e përcaktuar në urdhrin e prokurimit nr. ____, datë ____/____/2024, të titullarit të autoritetit kontraktor, në lidhje me argumentimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim, për procedurën e prokurimit me të dhënat e mëposhtme :

OBJEKTI I PROKURIMIT : “Rehabilitimi i kanalit ujitës të tokave bujqësore të fshatit Kuç”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) :
45247111-1 Punime ndërtimi për kanale ujitëse

VLERA E FONDIT LIMIT : 29,303,074 (njëzet e nëntë milion e treqindë e tre mijë e shtatëdhjetë e katër) lekë **pa TVSH.**

Argumentimi : Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është referuar në preventivin e hartuar mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Himarë (Njësia e Prokurimit), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TE KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet te paraqese:

a. Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces 8,

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

b. Sigurimin e Ofertes, sipas Shtojces 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik

2. Ofertuesi duhet te paraqese:

2.1 Pershtatshmeria per te kryer veprimtarine profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të perzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kesaj shtojce (Shtojca 7).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomike duhet te paraqesin vertetim per xhiron vjetore per vitet financiare **2021, 2022, dhe 2023**, ku vlera e xhiros per 3 (tre) vitet e fundit duhet te jete jo me e vogel se 40 % e fondit limit te kontrates qe prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Ne lidhje me situaten ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojme qe operatorët ekonomike kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar per te zbatuar kontraten”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”, si dhe bazuar ne nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”. Vendosija e ketij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë

disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qellim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së përllogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021, 2022, dhe 2023**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjeshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 3,të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke pasur parasysh që lloji i procedurës është “e hapur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ”Autoriteti/entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar. Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjithë

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2024** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar,

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dheneni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 (Pervoja te meparshme)

- Pune te ngjashme per nje objekt te vetem ne nje vlere jo me te vogel se **50%** e vleres se perlllogaritur te kontrates qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate pese viteve te fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates;
ose
- pune te ngjashme deri ne nje kufi, ku vlere monetare totale e puneve te kryera, e marre se bashku gjate pese viteve te fundit, eshte jo me e vogel se **100%** e fondit limit te kontrates qe prokurohet.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Per plotesimin e ketyre kritereve Operatori Ekonomik duhet te paraqese:

- a) Ne rast se punimet jane kryer **me ente publike**: Autoriteti Kontraktor, si deshmi per pervojen e meparshme kerkon :
 - i.** Kontraten e Sipermarrijes,
 - ii.** Situacionin perfundimtar te objektit
 - iii.** Aktin e Kolaudimit te objektit
 - iv.** Formular Vleresimi nga Investitori sipas shtojces nr. 9
- b) Ne rast se punimet jane kryer **ne sektorin privat**: Autoriteti Kontraktor, si deshmi per pervojen e meparshme kerkon:
 - i.** Kontraten e Sipermarrijes,
 - ii.** Situacionin perfundimtar te objektit
 - iii.** Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor

Kontrata te ngjashme konsiderohen te vlefshme nese zerat kryesore te punimeve kane volume te konsiderueshme krahasimore te percaktuara ne kete prokurim.

Pika a) plotesohet nga anetari i cili ka perqindjen me te madhe te pjesemarrjes ne bashkim. Anetaret e tjere te bashkimit do te paraqesin kontratat e ngjashme ne raport me perqindjen e pjesemarrjes se tyre ne bashkim. Kurse pika b) duhet te plotesohet nga te gjitha anetaret e bashkimit ne raport me perqindjen e pjesemarrjes se tyre ne bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me te vogel se dyfishi i vlerës limit të objektit te prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçense profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçense të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën perkatese të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Per punimet e pergjithshme te ndertimit:

- **Kategoria NP-1 – Klasifikimi A**
- **Kategoria NP-7- Klasifikimi A**
- **Kategoria NP-12 – Klasifikimi A**

▪ **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

- **Kategoria NS-18 – Klasifikimi A**

** Per Operatorët e huaj te behet nje hesimi i licenses profesionale qe disponojne nga vendi i origjines prane Ministrise se Puneve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit ne plotesimin e liçensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontrates.*

* Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike, Licensat profesionale duhet t'i paraqese operatori ekonomik qe ka marre persiper punimet per te cilat kerkohe Licensa Profesionale.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 8 përcakton "Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	Sipas preventivi zërai numer 1 , 2 , 3	Klasifikim A (0 - 20 milione lekë)	
NP- 7	Ujesjelles,gazsjelles, vajsjelles, vepra kullimi e vaditje	Sipas preventivi nga zërai numer 4 deri 21	Klasifikim A (0 - 20 milione lekë)	
NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	Sipas preventivit	Klasifikim A (0 - 20 milione lekë)	
N.S-18	Punime topogjeodezike	Sipas projektit dhe specidikeimeve	Klasifikim A (0 - 20 milione lekë)	

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te kete nje punesimin mesatar jo me pak se 35 (tridhjetë e pesë) **punonjes** me kohe te plote pune për muajin e fundit, ku përfshihen edhe Stafit menaxherial i Drejtuesve Teknik. **Per vertetimin e ketij kushti te paraqiten:**

1. Vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj per periudhen e mesiperme.

2. Listpagesa e Kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore te konfirmuara nepermjet formes elektronike nga organet tatimore per periudhen e mesiperme.

Argumentim: Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar në kriteret e struktureve të kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të t'i dhene garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, si dhe kohëzgjatjen e saj. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje per periudhen e muajit te fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialiste dhe certifikimet perkatëse, si me poshte:

- a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në liçence të shoqërisë e të punësuar si drejtues Teknik në stafin e tij për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontrate pune të vlefshme, diplome, CV, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhen e kërkuar në pikën 2.3.4, stafin inxhinierik si me poshte:

• Teknik Topograf	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
• Betonues	3 (tre)	Certifikate Trajnimi/ Diplome
• Muratorë suvatues	2 (dy)	Certifikate Trajnimi/ Diplome
• Saldator	2 (dy)	Certifikate Trajnimi/ Diplome
• Karpentier	3 (tre)	Certifikate Trajnimi/ Diplome
• Punonjes per prerje bimesh	2 (dy)	Certifikate Trajnimi/ Diplome
• Shofer	4 (kater)	Leje Drejtimi
• Manovrator Profesionale	4 (kater)	Certifikate e Aftesise
○ (CAP)		

(Ne rastet kur mjetet/makinerite disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar).

* Ne lidhje me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje dokumentacionin qe verteton profesionin si :

- Kontratat e punes individuale te vlefshme
- Per stafin e mesiperm, Deshmia e kualifikimit/ certifikate dhe/ose diploma e cila te jete e leshuar nga Ministria e Financave ose te njihet nga Ministria e Punes Ceshtjeve Sociale te paraqitet certifikata/diploma profesionale per secilin. Certifikatat / diplomat duhet te jene te leshuara nga institucione publike/private te licensuara sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.”, i ndryshuar. Kjo kerkese po ashtu eshte ne perputhje me vendimin nr. 441/2020, date 09.10.2020 te Komisionit te Prokurimit Publik. Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma te cilat nuk jane te licencuara sipas legjislacionit ne fuqi do te konsiderohen si dokumenta te rreme te cilat perbejne shkak per skualifikim dhe/ose perjashtimin e ketij kontraktori nga pjesemarrja ne prokurimet publike.
- **Certifikate te sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT) e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise**
- **Diplome nga institucionet e arsimit te mesem profesional(publik/privat) te akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne RSH”, kontrate pune te vlefshme dhe te figuroje ne listepagesa.**
- **Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:**

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit te marredhenieve t punes	Nr. Amzes/ekuivalent diplomes/certifikates profesionale	Institucioni/ Subjekti certifikues	Data e vlefshmerise se certifikates profesionale
----	--------------	------------	--	---	------------------------------------	--

Kriteri konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit te vetedeklarimit sipas shtojces 8 te DST.

Shenim: Referuar pikes 1, te nenit 26, te VKM nr.285, date 19.05.2021, **i ndryshuar**, ku parashikohet :
“*Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas percaktimit ne nenin 82, te LPP-se, dhe ne keto rregulla*”,
si dhe percaktimet e pikes 6, te ketij neni, ku parashikohet: “**Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njesuara me origjinalin**”.

Argumentimi: Kjo kerkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”. Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Certifikimet /diplomat profesionale duhet të jenë te lëshuara nga instuticione te licensuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga instuticione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare te Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Percaktimi i numrit te punonjesve dhe profesionet eshte bazuar mbi zerat dhe volumet e punes si dhe afateve per perfundimin e punimeve, ne mbeshtetje te Manualit te ndertimit miratuar me Vendim nr.629, date 15.07.2015 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar ne kater elementet e struktures se koston(material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

- c) Operatoret ekonomik pjesemarrres duhet te kene te punesuar si staf mbeshtetes per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt, te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, te pajisur me certifikate/deshmi trajnimi te leshuar nga subjekte te akredituar sipas ligjit, si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqerise per periudhen e kerkuar ne piken 2.3.4, punonjes me specialitetin si me poshte:
- Minimumi **1 (nje) person** qe permbush kriteret per te qene “**Ekspert per Ndihmen e pare dhe**

Nderhyrjen ndaj Emergjencave” nga kryqi i kuq ose organe te akredituar te njohur nga Republika e Shqiperise.

- Minimumi 1 (nje) **persona** qe permbush kriteret per te qene **“Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune”** leshuar nga organe te akredituar te njohur nga Republika e Shqiperise.
- Minimumi 1 (nje) **person** qe permbush kriteret per te qene **“Ekspert Zjarrfikes i pajisur me Licence I.2.A** ne perputhje me piken 4, te nenit 49, te Ligjit Nr.152/2015 “Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin”. Per kete duhet te paraqitet Certificate/deshmi per ekspert zjarrfikes te leshuar nga Ministria e Puneve te Brendeshme, diploma dhe kontrata noteriale e punes.”

Në rastin e BOE, specialistët e mësipërm mjafton të plotësohen nga anëtari i cili do të marrë përsipër punimet konkrete.

Per kete operatoret ekonomike duhet te paraqesin :

- Kontratat e punes te vlefshme;
- Dokument (deshmi kualifikimi profesional), qe te vertetoje kualifikimin profesional te kerkuar, referuar rregullores “Per kushtet, kriteret dhe programet per pergatitjen teoriko-praktike te kandidateve, si dhe dhenien e Deshmise se Aftesise Profesionale per perdoruesit e makinerive te renda per punime ndertime dhe toke, si dhe disiplinimi i perdorimit te tyre”, miratuar me urdherin nr. 200, date 16.5.2019, te Ministrit te Infrastruktures dhe Energjitikes.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet plotesimit dhe paraqitjes nga operatoret ekonomike te formularit permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojces 8 te DST.

Dokumentacioni provues do te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar ne vend te pare, prane autoritetit kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, ose nese do te jete nevoja per tu kerkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“. "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojne çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çenojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi. Bazuar dhe ne V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për shkak të natyrës së punimeve që kryhen të cilat kanë potencial të shkaktojnë aksidente me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh

ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e **1(një) punonjes Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave.**

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë licence lidhur me ndikimin në mjedis të lëshuar nga QKL kodi III.2.B **“Grumbullim dhe transportim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”**

Në rastin e BOE, specialistët e mësipërmë mjafton të plotësohen nga anëtarët e cilëve do të marrë përsipër punimet konkrete.

Argumentimi : Kërkesat e mesipërme janë vendosur në zbatim të ligjit 162/2020 Për prokurimin Publik dhe VKM- nr. 285 datë 19.05.2021 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nën 39 pika 6 Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose Autoriteti kontraktor në vendosjen e këtyre kritereve ka patur parasysh trajtimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta që do të dalin gjatë kryerjes së punimeve, faktin që objekt i këtij prokurimi ka punime të mëdha të tjera, Gjithashtu bazuar në Ligjin Nr.10463 dt.22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, është kërkuar të disponojë këto licence me qëllim për të mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe të sigurojë mekanizimin mjedisor të mbetjeve nën 57.

a. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontate Furnizimi Për Materialet si më poshtë:
Hekur Autorizim Prodhuesi/Distributori të autorizuar të paraqitet kataloget përkatës dhe ISO 9001/ekuivalente për cilësinë

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nën 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nën 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose marrëveshje bashkëpunimi ose autorizimit të distributorit të autorizuar për furnizimin e mallrave që do të ofertojnë, është kërkesë ligjore e domozdoshme, me qëllim që OE të kenë autorizimin për tregtimin e produkteve nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, apo marrëveshje bashkëpunimi, duke treguar origjinalitetin e tyre dhe ofruar garanci për mallrat që do të furnizohen.

Për nga vetë natyra e veçante e procedurës së prokurimit, me qëllim realizimin e kontratës që prokurohet, kriteri i sipërcituar është një kërkesë e nevojshme që lidhet drejtpërdrejt me rëndësinë dhe natyrën e objektit që prokurohet dhe që mund të plotësohet nga çdo operator ekonomik, cili ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e procedurës. Gjithashtu OE duhet të paraqesin skemat teknike/katalogë për disa prej artikujve kryesor të objektit të prokurimit, ku të shprehin qartë secilin lloj të mallit që ofertojnë, për të gjykuar nëse malli që do të lëvrohen nga operatorët ekonomikë janë

në përputhje të plotë me specifikimet teknike dhe se OE do të furnizojë me ato mallra që ka paraqitur në ofertën e tenderit dhe për të cilën do të jetë shpallur fitues. Kërkesa për skedat teknike/katalogë certifikatë CE ose raportet e testimit është vendosur për pajisjet që kanë një rëndësi të vecante për AK dhe një vlerë të konsiderueshme.

2.3.6 (Makineri, Pajisje)

a) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, automjetet dhe pajisjet (sipas tabelës) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vertetuara këto me dokumentacionin përkatës;**

Nr	Emertimi	Forma e disponimit	Njesia	Sasia
1.	Kamion vetëshkarkues me kap mbajtës 8 – 12 ton	Ne pronësi, kontratë qiraje	Cope	2
2.	Minifadromë (mjet teknologjik)	Ne pronësi, kontratë qiraje	Cope	1
3.	Kamioncine me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton	Ne pronësi, kontratë qiraje	Cope	1
4.	Damper me goma (mjet teknologjik me goma) 4 ton	Ne pronësi, kontratë qiraje	Cope	1
5.	Autovinç deri në 5 ton	Ne pronësi, kontratë qiraje	Cope	1
6.	Ekskavator me goma (mjet teknologjik) 0.25 m ³	Ne pronësi, kontratë qiraje	Cope	2
7.	Minieskavator me zinxhirë	Ne pronësi, kontratë qiraje	Cope	1
8.	Minieskavator me goma	Ne pronësi, kontratë qiraje	Cope	1
9.	Autobetoniere kantieri (mjet teknologjik)	Ne pronësi, kontratë qiraje	Cope	2
10.	Autopompe betoni	Ne pronësi, kontratë qiraje	Cope	1
11.	Autobot uji	Ne pronësi, kontratë qiraje	Cope	1
12.	Koke terheqese	Ne pronësi, kontratë qiraje	Cope	1
13.	Betoniere kantieri	Ne pronësi, kontratë qiraje	Cope	2
14.	Saldatrice	Ne pronësi, kontratë qiraje	Cope	1
15.	Vibratorë	Ne pronësi, kontratë qiraje	Cope	2
16.	Helikopter nivelues	Ne pronësi, kontratë qiraje	Cope	1
17.	Aparat topogjeodezik me GPS	Ne pronësi, kontratë qiraje	Cope	1

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-se Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – jo me pak se 35 cope
- Jeleke – jo me pak se 35 cope

- Prozektore ndriçimi naten – *jo me pak se 15 cope*
- Komplet i ndihmes se shpejte – *jo me pak se 5 cope*
- Fikese zjarri te levizshme me kapacitet 5-7 litra – *jo me pak se 10 cope*
- Tabela paralajmëuese per sigurine ne objekt – *jo me pak se 10 cope*
- Rripa sigurie – *jo me pak se 35 cope*

Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore- leja e transportit, si dhe të paraqesë foto të qarte për secilin mjet dhe të jetë e dukshme targa e mjetit.
- Ndërsa për mjete të marra me qera/kontrata bashkëpunimi krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qera/ Kontrata bashkëpunimi, krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase..

Shënim: Kjo kërkesë permbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëpërmjet këtyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistët e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zerave përkatës të Preventivit. Numri i makinerve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit). Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të volumeve dhe grafikut të punimeve pra verteton se ofertuesi i mundshëm zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te disponoje ne pronesi, qira ose kontrate bashkepunimi impiantet si me poshte vijon:

. 1 (nje) Impiant prodhimi Betoni

Argumentimi Ne baze te nenit 77 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe piken 8, te nenit 40, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", me ane te ketij kriteri AK gjykon se disponimi ne pronesi apo me qera i ketyre fabrikave eshte nje dokument i rendesishem, pasi pervec se tregon origjinen e mallrave qe kerkohen ne procedure, garanton se ofertuesi eshte i garantuar per ofrirmen tek Autoriteti Kontraktor te ketyre mallrave qe do te perdoren ne punimet e planifikuara. Kjo garanci lidhet njekohesisht edhe me treguesit cilesore te mallrave objekt prokurimi te cilat kerkohen qe te jene prodhuar ne perputhje me standardet dhe cilesite e kerkuara ne DST. Ky kriter eshte ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates dhe lidhet drejtperdrejte me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine e OE ofertues per aftesite teknike. Kjo kerkese i sherben autoritetit kontraktor per njohjen e mundesise se OE per permbushjen me sukses te kontrates pasi sasia e produkteve qe do te perdoren eshte e konsiderueshme.

2.3.9. Operatori Ekonomik duhet te paraqese Çertifikaten ISO, si me poshte:

- **ISO 9001:2015 (Sistem i Menaxhimit te Cilesise)**
- **ISO 14001:2015 (Sistem i Menaxhimit Mjedisor)**
- **ISO 45001:2018 (Sistem i Menaxhimi i sigurise dhe Shendetit ne pune)**
- **ISO 3834-2:2021 (Sistemi i Manaxhimit të Cilësisë për Saldim me Shkrirje të Materialeve Metalike)**

Çertifikata e mesiperme duhet te jete e vlefshme ne daten e hapjes se ofertave. Nese çertifikata eshte ne gjuhe te huaj duhet te shoqerohet me perkthimin ne gjuhen shqipe te noterizuar. Çertifikata e mesiperme duhet te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Ne rast te bashkimit te operatoreve ekonomike ISO duhet plotesuar nga operoret ekonomike, sipas natyres se puneve qe marrin persiper.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “d” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët,*

mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Te gjitha dokumentet duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes se nje dokumenti, ose dokumente false dhe te pasakta, konsiderohen kushte per skualifikim.

NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT